



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETITIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2022

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga subjekti VOX News

Z. Robert Hasa

Email- roberthasa9@gmail.com

Adresa: Rruga : “Hamdi Garunja” 1020, Pallati Viki shpk Shk. D Ap 4 D

TIRANË

I nderuar z. Hasa,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion nr. 1370 (tonën) prot. datë 09.08.2022, email i datës 27.07.2022 (por që për shkak të mosfunksionimit të emailit zyrtar kjo kërkesë është vënë në dispozicion në datën 08.08.2022) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) për informacion, ju informojmë si më poshtë:

Së pari baza ligjore në kërkesën tuaj për informacion, është vendosur bazuar në ligjin nr 119/2014 “Për të drejtën e Informimit“.

Por nga shqyrtimi i objektit të kërkesës vërehet se kërkesa juaj për informacion i nënshtrohet dhe rregullohet nga dispozitat e ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.

Ligjvënësi me ligjin 45/2015, i ka dhënë institucionit të Autoritetit kompetenca për të kryer detyrën funksionale dhe për të informuar kërkuarit (institucion, individ, studiues/media), duke pasur parasysh që, në secilën vendimarrje të Autoritetit të mbrojtë interesat e individit/individëve, interesat e shtetit (Siguri Kombëtare/Sekret shtetëror) si dhe interesat publike.

Ligji organik nr. 45.2015 normon veprimtarinë funksionale të Autoritetit, si ligj i posacëm, që gjen zbatim duke preluar mbi ligjin nr. 119.2014, i cili zbatohet për atë që është e mundur dhe nuk bie ndesh me ligjin organik, por edhe me ligjin për arkivat pasi informacioni që kërkohet për vënie në dispozicion është dokumentacion arkivor.

Kërkesa juaj për informim i nënshtrohet dispozitave procedurale për mënyrën se si të aksesohet informacioni, sipas dispozitave njohëse dhe kufizuese të ligjit nr. 45/2015.

Ligji nr. 45/2015, përcakton qartë subjektet kërkuar që mund të kenë qasje në informacion, objektin, qëllimin dhe përdorimin e informacionit, të drejtat e kërkuarve, mbrojtjen e palëve të prekura apo të tretëve si dhe kriteret e përdorimit të informacionit.

Sipas Nenit 20 të ligjit nr. 45/2015

Garantimi i së drejtës për informim

1. Kërkuesit i njihet e drejta për t'u njohur me dokumentet *kur ai ka cilësinë e të prekurit, palës së tretë, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit* të ish-Sigurimit të Shtetit ose është një përfaqësues me prokurë i këtyre të fundit. Kjo e drejtë përfshin njohjen dhe shqyrtimin e dokumenteve origjinale ose dublikatave të tyre.

Sa më sipër çdo individ në cilësinë e kërkuesit ka mundësi të aplikojë për informacion në Autoritet, për veten ose të afërmit të tij brenda parashikimit të ligjit 45/2015, duke plotësuar formularin përkatës të miratuar nga Autoriteti.

Në Nenin 34 të ligjit nr. 45/2015 parashikohet se

“Informacionet që lidhen me persona, të marra në përputhje me parashikimet e këtij kreu, përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë kërkuar, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ky ligj”.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik” në fushën e së drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, konkretisht ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, informacionet që disponon Autoriteti si dokument i një natyre të posaçme, qoftë për subjektin e verifikimit, qoftë për individin si kërkues në cilësinë e të prekurit përmbajnë të dhëna personale të subjekteve, personave të tjerë, të cilat gëzojnë ruajtje sipas legjislacionit në fuqi, subjektit kërkues i shpjegohet se për të mbrojtur të drejtat e kërkuesit, ky informacion do të jetë konfidencial vetëm për atë dhe askënd tjetër dhe për këtë arsye nuk mund t'i vendosen asnjë pale tjetër në dispozicion me përjashtim të institucioneve të përcaktuara nga ligji dhe kërkuesit si subjekt i këtij ligji.

Nisur nga rastet konkrete dhe problemarikat e ndeshura në vite, u informua (si detyrim ligjor për raportim) dhe kërkua nga organi më i lartë nga ku buron detyrimi ligjor, Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë që të veprohet për ndryshime të mëtejshme ligjore, në këtë kuadër, Autoriteti ka paraqitur pranë Kuvendit edhe Vendimin nr. 321 datë 26.07.2022, me objekt miratimin e propozimeve të ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 45/2015 i ndryshuar dhe në Kodin Zgjedhor.

Ligji nr. 45/2015 parashikon në nenin 38 “**Informimi i medias**” të drejtën e përfaqësuesve të medias për të konsultuar të dhënat e Sigurimit ku përcaktohet.

1. Vënia në dispozicion dhe përdorimi i dokumenteve nga media kryhet në përputhje me nenet 36 dhe 37 të këtij ligji.

2. Kur publikimi i të dhënave personale, të siguruara sipas këtij ligji, shoqërohet me deklaratat kundërta të personave të përmendur, këto deklaratat u bashkëlidhen të dhënave personale dhe ruhen, vihen në dispozicion e lejohet të publikohen, në të ardhmen, vetëm së bashku me deklaratat kundërshtuese.

Bazuar në dispozitën e mësipërme të ligjit të posaçëm nr. 45/2015 lidhur me procedurën për shqyrtimin e dokumenteve, vënien në dispozicion dhe përdorimin e dokumenteve nga media, nevojitet të plotësoni formularin përkatës për studiues, media i miratuar nga Autoriteti me qëllim adresimin e kërkesës tuaj, në dispozitën e përcaktuar nga ligji e më pas vijimin e

trajtimit të kërkesës. Kjo qasje do të garantohet në kushte që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe privatësinë e individëve të përmendur në dosje.

Bashkëlidhur gjeni formularin për studiues/media të miratuar nga Autoriteti.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Në mungesë dhe me Urdhër

Drejtori i Informacionit

Selami Zalli

Konceptoi: L. Cocoli
Datë: 10.08.2022